



BASHKIA
TIRANË



Drejtuar: Operatorit Ekonomik "Dajti Park 2007" shpk

Adresa: Godinë banimi dhe shërbimesh 3,4 kate +nencati+ 2 kate bodrum, kt.1, Lagjja Qesarakë, Tiranë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: **"Rikonstruksioni i tre fushave sportive në shkollën 9 – vjecare "Katund i Ri" dhe shkollën e mesme "Sadik Stavileci".**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Rikonstruksioni i tre fushave sportive në shkollën 9 – vjecare "Katund i Ri" dhe shkollën e mesme "Sadik Stavileci"**, duke realizuar rikonstruksionin e tre fushave sportive në shkollën 9 – vjecare "Katund i Ri" dhe shkollën e mesme "Sadik Stavileci, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit

Nr.REF. 85348-09-11-2018

Fondi limit: 6.557.413 (gjashte milion e pesëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e trembëdhjetë) **lekë pa TVSH.**

Burimi i financimit: Vënë në dispozicion nga Kontrata e Grantit nr. 07 datë 13.07.2018, ndërmjet Fondacionit "Programi i Zhvillimit Rajonal Shqipëri" dhe Bashkisë Tiranë.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **datë 24.09.2018 , ora 11:00**

Publikime të mëparshme: *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini i Njoftimeve Publike nr.37 datë 17.09.2018**

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik "Dajti Park 2007" shpk NUIS K11507003W

Vlera e ofertës pa TVSH =4.930.495 (katër milion e nëntëqind e tridhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e pesë) **lekë**

2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Sinder AB” shpk & “Klajger Konstuksion” shpk me nr. NUIS K01531003Ë & K51423028P

Vlera e ofertës pa tvsh = **5.592.762,50** (pesë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy presje pesëdhjetë) **lekë**

3. Operatori ekonomik “CAUSHI” shpk, me nr. NUIS J97511807Ë

Vlera e ofertës pa tvsh = **6.495.275** (gjashtëmilion e katërqind e nëntëdhjetë e pesëmijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë) **lekë**

Janë skualifikur ofertuesit e mëposhtëm:

1- Operatori Ekonomik “Dajti Park 2007” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Operatori ekonomik **“Dajti Park 2007” shpk**, nuk plotëson pikën 2.7 të Kriteret e Vecanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik.

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2(dy) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda nga të cilët një automakinist dhe një eskavatorist. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga verifikimi i dokumentave të operatorit ekonomik në sistemin elektronik të APP-së konstatoi se shoqëria “Dajti Park 2007” shpk, *nuk ka paraqitur asnjë punonjës manovrator të paisur me dëshmitë drejtimit për automakinist.* Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i shoqërisë lidhur me kriterin e mësipërm është i paplotë për rrjedhojë i pasaktë.

Së dyti Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Vecanta të Kualifikimit ka kërkuar si më poshtë cituar:

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca 9)

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion dy kamiona vetëshkarkues **kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 3.5 ton dhe maximumi 5 ton secili kamion** për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri asnjë kamion me kapaciteti mbajtës minimumi 3.5 ton dhe maximumi 5 ton secili kamion nga dy të kërkuara.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë lidhur me kamionat vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 3.5 ton dhe maksimumi 5 ton të kërkuar nga AK (2 cope), **për rrjedhojë i pavlefshëm.**

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 9, është i paplotë, **për rrjedhojë i pavlefshëm**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Bashkimi I Operatorëve Ekonomikë “Sinder AB” shpk & “Klajger Konstruksion” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Bashkimi I Operatorëve Ekonomikë “Sinder AB” shpk & “Klajger Konstruksion” shpk se oferta e deklaruar në formularin e ofertës është **5.592.762,50** (pesë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy presje pesëdhjetë) **lekë pa TVSH.**

Oferta ekonomike e deklaruar në preventivin e punimeve është **5.952.762,50** (pesë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy presje pesëdhjetë) **lek pa tvsh.** Ka gabim në ofertën ekonomike të deklaruar në preventiv me formularin ofertës.

Autoriteti kontraktor ka kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik pika 3

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion dy kamiona vetëshkarkues **kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 3.5 ton dhe maksimumi 5 ton secili kamion** për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri asnjë kamion me kapaciteti mbajtës minimumi 3.5 ton dhe maksimumi 5 ton secili kamion nga dy të kërkuara.

Dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik lidhur me shtojcën 9, është i paplotë në lidhje me Autobot uji, Autobetonier dhe Eskavator me goma 0.25 m3, pasi BOE ka paraqitur vetëm faturat e shitjes për këto mjete.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 9, është i paplotë, **për rrjedhojë i pavlefshëm**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3.Operatori Ekonomik “CAUSHI” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

- *Autoriteti kontraktor ka kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Ekonomik dhe finaciar pika 2.2 nën-pika 1, ka kërkuar si më poshtë cituar:*

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **3.278.706** (tremilion e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e gjashtë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e zhvillimit të tenderit.*
- punë të ngjashme deri ne nje kufti ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **13.114.826** (trembëdhjetë milion e njëqind e katërbëdhjetë mijë e tetëqind e njëzet e gjashtë) lekë pa TVSH.*

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Operatori Ekonomik “Caushi” shpk, në përmbushje të këtij kriteri nuk ka paraqitur në sistemin elektronik të APP-së asnjë punë të ngjashme, me objektin e procedurës së prokurimit.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion dy kamiona vetëshkarkues **kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 3.5 ton dhe maksimumi 5 ton secili kamion** për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri asnjë kamion me kapaciteti mbajtës minimumi 3.5 ton dhe maksimumi 5 ton secili kamion nga dy të kërkuara.

Dokumentacioni i makinerisë, Fadromë me goma, është i pa plotë. OE ka paraqitur vetëm faturën tatimore të shitjes.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 9, është i paplotë, **për rrjedhojë i pavlefshëm.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Kreu III, Neni 24, pika 1, gërma ç, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi të njoftojë menjëherë operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, se asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 04.10.2018

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, është paraqitur Formulari i Ankesës nga Operatori Ekonomik **“Dajti Park 2007” shpk**, hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën Nr. 37224 Prot. datë 09.10.2018 (administruar në dosjen e

prokurimit) në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit me objekt: **”Rikonstruksioni i tre fushave sportive në shkollën 9 – vjecare ”Katund i Ri” dhe shkollën e mesme ”Sadik Stavileci”**.

Me marrjen e ankesës nga Operatori Ekonomik i mësipërm, në mbështetje të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 ”Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 63, pika 3 si dhe në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me Urdhërin me Nr. 32971/3 Prot. dt. 09.10.2018, është pezulluar procedura e prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas rregullave të parashikuara nga LPP dhe RRPP.

Gjithashtu në mbështetje të pikës 6/a të Kreut X, neni 78 te Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me urdhër 32971/4 datë 09.10.2018, u ngrit Grupi i Shqyrtimit të Ankesave i cili pasi u njoh me pretendimet e Operatorit Ekonomik **“Dajti Park 2007” shpk**, konkludoi në pranimin e ankesës dhe shpalljen si ofertë të vlefshme për procedurën e prokurimit me objekt:

”Rikonstruksioni i tre fushave sportive në shkollën 9 – vjecare ”Katund i Ri” dhe shkollën e mesme ”Sadik Stavileci”.

Autoriteti Kontraktor, i ktheu përgjigje **Operatorit Ekonomik “Dajti Park 2007” shpk**, me shkresën nr. 37224/2 prot, datë 12.1.2018 (administruar ne dosjen e prokurimit).

Më datë 15.10.2018, me anë të shkresës nr. 32971/5 datë 15.10.2018, është hequr pezullimi i procedurës së prokurimit

Referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave të datës 04.10.2018, si dhe Udhezimit per zhvillimin e procedurave me mjete elektronike, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, vendosi të kryejë riklasifikimin e ofertave në platformën elektronike të prokurimit publik për procedurën e prokurimit me objekt:

”Rikonstruksioni i tre fushave sportive në shkollën 9 – vjecare ”Katund i Ri” dhe shkollën e mesme ”Sadik Stavileci”.

Riklasifikimi dhe renditja përfundimtare për procedurën me objekt:

”Rikonstruksioni i tre fushave sportive në shkollën 9 – vjecare ”Katund i Ri” dhe shkollën e mesme ”Sadik Stavileci”.

është si më poshtë vijon:

Operatori Ekonomik “Dajti Park 2007” shpk, kualifikohet në vend të parë.

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **4.930.495** (katër milion e nëntëqind e tridhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e pesë) **lekë**.

Çmimi total i ofertës me tvsh = **5.916.594** (pesëmilion e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e katër) **lekë**. Afati kohor për zbatimin e punimeve është 3 (tre) muaj.

Operatorët Ekonomikë të skualifikuar janë:

- **Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Sinder AB” shpk & “Klajger Konstruksion” shpk**
- **Operatori Ekonomik “Caushi” shpk**

Njoftimi i Riklasifikimit është bërë në datë 16.10.2018

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë formular ankese.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se **Operatorin Ekonomik ”Dajti Park 2007” shpk, me adresë:** Godinë banimi dhe shërbimesh 3,4 kate +nencati+ 2 kate bodrum, kt.1, Lagjja Qesarakë, Tiranë, me nr. NIPTI K11507003W, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa TVSH **4.930.495** (katër milion e nëntëqind e tridhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e pesë) **lekë, është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, 1001, Tiranë, Sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) , siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar

